

UDHËZIM
Nr. 19, datë 1.8.2014

**PËR PROCEDURAT E PROCESIT TË KONKURRIMIT PËR TEKSTE TË BOTUESVE TË HUAJ
PËR GJUHËN FRËNGE, PËRZGJEDHJEN DHE SHITJEN E TYRE PËR VITIN SHKOLLOR 2014-
2015**

Në mbështetje të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 47, të ligjit nr. 69/2012, datë 21.6.2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë” dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 107, datë 10.2.2010, “Për botimin, shtypjen, shpërndarjen dhe shitjen e teksteve shkollore të sistemit arsimor parauniversitar”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Shpalljen e konkurrimit për pranim alternativash të teksteve të gjuhës frënge për klasat 11 dhe 12, në përputhje me kurrikulën bërthamë dhe kurrikulën me zgjedhje të gjimnazit, në sistemin e arsimit parauniversitar në Republikën e Shqipërisë, për shkak të mungesës së teksteve dhe për të mundësuar pajisjen e nxënësve me tekste të botuesve të huaj.

2. Kërkesa, datat dhe detaje të tjera të procesit të konkurrimit të publikohen në faqen zyrtare elektronike të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit sipas aneksit “Për shpalljen e kërkesës për tekste të botuesve të huaj për gjuhën frënge”, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

3. Ministria e Arsimit dhe Sportit të ngrejë komisionin me specialistë të fushës për të bërë vlerësimin e përshtatshmërisë së teksteve me kurrikulën përkatëse. Komisioni të përbëhet nga së paku dy mësues me përvojë të gjuhës frënge, si dhe një pedagog i gjuhës frënge i Universitetit të Tiranës.

4. Përzgjedhja e teksteve të miratuara sipas këtij udhëzimi të bëhet nga mësuesit në shkolla sipas modaliteteve të udhëzimit të kësaj ministrie nr. 8, datë 24.3.2014 “Për përzgjedhjen dhe shitjen e teksteve shkollore për vitin shkollor 2014-2015”, të ndryshuar, por pa cenuar përzgjedhjen e realizuar sipas tij.

5. Çmimet e shitjes me pakicë të këtyre teksteve në Shqipëri, të ofruara nga botuesit ose distributorët e autorizuar, të pranohen jo më lart se mesatarja e çmimeve aktuale të teksteve të gjuhëve të huaja për klasën dhe kurrikulën përkatëse, të përlogaritura nga MAS.

6. Në procesin e shpërndarjes dhe shitjes, tekstet e miratuar sipas këtij udhëzimi të jenë të pajisura me pullën me hologramë të certifikimit nga Ministria e Arsimit dhe Sportit. Shitja e teksteve të bëhet nëpërmjet njërive tregtare të shitjes së librave ose në pika të tjera shitjeje pranë shkollave nga subjekte të licencuara deri në 15 shtator 2014.

7. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Arsimit Parauniversitar, Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme, drejtoritë arsimore rajonale dhe zyrat arsimore.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SPORTIT
Lindita Nikolla

ANEKS

PËR SHPALLJEN E KËRKESËS PËR TEKSTE TË BOTUESVE TË HUAJ PËR GJUHËN FRËNGE

Në mbështetje të nenit 47 të ligjit nr. 69/2012, datë 21.6.2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë” dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 107, datë 10.2.2010 “Për botimin, shtypjen, shpërndarjen dhe shitjen e teksteve shkollore të sistemit arsimor parauniversitar”, të ndryshuar, Ministria e Arsimit dhe Sportit shpall publikisht kërkesën për tekste të botuesve të huaj për gjuhën frënge për klasat 11 dhe 12.

Tekstet e kërkuara duhet të kenë detyruesisht përputhje me programin përkatës në fuqi të gjuhës frënge, me kurrikulën bërthamë dhe me zgjedhje të detyruar të gjimnazit, për klasën e 11-të dhe të 12-të. Libri i nxënësit duhet të jetë i shoqëruar detyruesisht me fletoren përkatëse të punës, njësi e ndarë fizikisht nga libri i nxënësit ose e përfshirë si pjesë e dallueshme në librin e nxënësit.

Kërkesat do të pranohen vetëm nëpërmjet distributorëve të autorizuar prej botuesve. Distributori duhet të jetë i njohur ligjërisht për shpërndarjen dhe shitjen e teksteve të miratuara në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

Në datën 11 gusht 2014, nga ora 12.00 deri 16.00 në adresën Ministria e Arsimit dhe Sportit, Drejtoria e Arsimit Parauniversitar, Sektori i Kurrikulës, Cilësisë dhe Koordinimit, Rruga e Durrësit nr. 23, Tiranë (personi i kontaktit z. Piro Milo), distributori duhet të paraqesë këto dokumente:

a) 3 (tri) kopje të librit të nxënësit për të cilin kërkohet miratimi (fletorja e punës, njësi e ndarë fizikisht nga libri i nxënësit ose e përfshirë si pjesë e dallueshme në librin e nxënësit).

b) Ekstraktin historik të QKR-së për regjistrimin si person juridik me të drejtë ushtrimi aktiviteti si distributor, si dhe NIPT-in e subjektit.

c) Vërtetim nga gjykata që distributori nuk është në proces gjyqësor.

d) Vërtetim nga Drejtoria e Tatimeve dhe e Taksave për shlyerjen e detyrimeve përkatëse (jo më të vjetra se 3 muaj nga data e lëshimit).

e) Vërtetim nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit që subjekti nuk ka detyrime financiare karshi të tretëve dhe që distributori që përfaqëson nuk është në proces falimentimi (jo më të vjetra se 3 muaj nga data e lëshimit).

f) Delegimin zyrtar të së drejtës për përfaqësim distributorit, lëshuar nga shtëpia botuese e huaj, e regjistruar në regjistrat përkatës profesionalë ose tregtarë të shtetit në të cilin është themeluar botuesi, duke vërtetuar personalitetin ligjor të botuesit.

g) Deklaratat për çmimin e shitjes së tekstit të nxënësit dhe të fletores së punës, të shënuara me shifra dhe me shkrim, të paraqitura të ndara, në zarfe të mbylura.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë në gjuhën shqipe, ose të përkthyer në shqip dhe të noterizuara. Dokumentet, në asnjë rast, nuk i kthehen dorëzuesit.